

VENDIM
Nr. 1000, datë 9.12.2015

**PËRSHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“NDËRTIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËS NGA MUZEU HISTORIK - SPITALI,
VLORË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës nga Muzeu Historik - Spitali, Vlorë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë totale të shpronësimit prej 18 146 972 (tetëmbëdhjetë milionë e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh.

4. Vlera totale e shpronësimit, prej 18 146 972 (tetëmbëdhjetë milionë e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të paraqesin dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lista e objekteve qe preken nga projekti: "Sistemim asfaltimi i rruges nga Muzeu Historik - Spitali Vlore".

Nr	Zona kadastrale	Nr. Pasurise	Adresa	Pronari	Siperfaqe Truallit	Siperfaqe ndertimi	Çmimi i Truallit Leke/m2	Çmimi i Ndertimit Leke/m2	Vlera e Truallit Leke	Vlera e Ndertimit Leke	Vlera truall dhe ndertese	Shenime sipas ZVRPP dhe dok. Te dorezuar
1	8601	7/200	Vlore	Kozma Tata	114	56	7,002	14,808	798,228	829,220	1,627,448	Certifikate pronesie
2	8601	7/159	Vlore	Ardian Dauti	0	66	7,002	14,808	0	878,287	878,287	Certifikate pronesie eshte mbajtur vlera e truallit per ndertimin jashte vijes se shpronësimit
3	8601	7/101	Vlore	Liri Shehu	27.98	0	7,002		195,916	0	195,916	Certifikate pronesie
4	8601	7/24	Vlore	Aranit Ibrahimaj		21	7,002	14,808	0	310,958	310,958	Vendim gjykate
5	8601	7/22	Vlore	Fitim Veizaj	0	20	7,002	14,808	0	296,160	296,160	Certifikate pronesie
6	8601	4/1	Vlore	B.P. Xhemali	53.03	100	7,002		371,316	5,734,457	6,105,773	Certifikate pronesie eshte mbajtur vlera e truallit per ndertimin jashte vijes se shpronësimit
7	8601	3/25	Vlore	Mahmut Balleshi	33.96	0	7,002		237,788	0	237,788	Certifikate pronesie
8	8601	3/85	Vlore	Mahmut Balleshi	42.7	0	7,002		298,985	0	298,985	Certifikate pronesie
9	8601	3/24	Vlore	Wilson Balleshi, Petrit Ba	7.18	109.2	7,002		50,274	0	50,274	saktesim dok.per truallin/P.P.V
10	8601	2/76	Vlore	Pellumb Ymeraj	16.17	107	7,002		113,222	5,886,312	5,999,534	sak. dok.Certifikate pronesie
11	8601	2/75	Vlore	Enver Resuli	0	36	7,002	61,655	0	2,145,849	2,145,849	Vendim gjykate
18,146,972												

V.o: cmimi i truallit eshte marre ne V.K.M NR. 514 date 30.07. 2014

cmimi i nderteses sipas z.v.r.p.p.

cmimi objekt banimi sipas Udhezimit Nr. 2, date 06.08.2014